



Drejtorati për Inspekcione

10 Nr. _____ /2022 Dt. 15 / 01 /2022

Për : Kryetarin e komunës së Deçanit- Bashkim Ramosaj,

Nga: Drejtori i Drejtoratit të Inspektionit-Halil Tolaj

Lënda: Plani i punës së Drejtoratit për Inspekcione për vitin 2022

Datë: 15.01. 2022

Me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe të transparencës si dhe forcimin e besimit të qytetarëve dhe subjekteve afariste në qeverisjen komunale, inspektorët e Drejtoratit Komunal për Inspekcione secili nga lëmi përkatëse gjatë vitit 2020 do të kryejnë çdo dit, në mënyrë të pavarur, çoftë në zyre apo drejtpërdrejt në teren detyrat dhe përgjegjësit që dalin nga ligjet e aplikueshme dhe aktet tjera nënligjore me të cilat rregullohet mbikëqyrja inspektuese sipas fushe veprimtarive përkatëse.

Drejtorati, gjegjësisht inspektorët përkatës përmes mbikëqyrjes inspektuese bëjnë zgjidhjen e çështjeve administrative si organ i shkallës së parë.

Përmes përcjelljes së gjendjes bëjnë propozimin e masave për përmirësimin e gjendjes në teren në teritorin e komunës në të gjitha lëmit nga fushë veprimtaria e drejtoratit,

Plani vjetor i mbikëqyrjes inspektuese përmban një pasqyrë të përgjithshme të punëve dhe detyrave të inspektorëve komunal për vitin 2022, në implementimin e drejtpërdrejtë të ligjeve, akteve tjera nënligjore, rregulloreve dhe vendimeve komunale si dhe përcjelljes së gjendjes në teritorin e komunës së Deçanit nga fushe veprimtaria e secilit inspektor komunal.

Inspektimet e rregullta kryhen çdo ditë sipas planit të inspektoreve, kurse sipas nevoje dhe kërkesave të paraqitura kryhen edhe inspektime të jashtëzakonshme, e në raste të caktuara kryhen edhe inspektime plotësuese dhe kontrolluese me qëllim të përcjelljes së plotësimit të rekomandimeve paraprahe të inspektorëve.

Inspektimet e pa planifikuara do të insistohet që të kryhen të njëjtën ditë të parashtrimit të kërkesës së qytetarit, subjektit apo të ndonjë organi tjetër me qëllim të parandalimit të dukurisë e cila bie ndesh me ligjet dhe aktet tjera normative nga lëmi përkatës.

Inspektorët përparësi do të ju japin vizitave këshillëdhënëse, ku subjektet e mbikëqyrura do të njoftohen me dispozitat ligjore përkatëse, plotësimet dhe ndryshimet eventuale të

tyre dhe do ju japin këshilla profesionale si masë parandaluese, duke mos përjashtuar lëshuarjën e aktvendimeve për ndalimin e aktiviteteve jashtë ligjore apo edhe ndërmarrjen e veprimeve ndëshkimore ne harmoni me Ligjet përkatëse.

Moto e punës së inspektoreve do të jetë kontrolli së paku njëherë i të gjitha subjekteve që i nënshtrohen mbikëqyrjes inspektuese sipas ligjeve dhe akteve në fuqi, por edhe shmangja në maksimum i kontrolleve të përsëritura pa nevojë.

Në kuadër të Drejtoratit veprojnë këta Inspektor:

- shefi i inspekcionit si koordinator i punës së inspektorëve në të njëjtën kohë edhe inspektor për bujqësi,
- Inspektori i tregut,
- Inspektori i mbrojtjes së ambientit.
- Inspektori i Ndërtimit (i angazhuar me kontrate),
- Inspektori i veterinarisë (i angazhuar me kontratë mbi shërbimet e veçanta)

Deri në përfundim të vitit 2021 në kuadër të Drejtoratit ka vepruar edhe Inspektori Sanitar i cili tashmë është bartur në Agjensionin e Veterinarisë dhe ushqimit.

Përveç punëve dhe detyrave të punëve sipas ligjeve dhe akteve tjera nënligjore përkatëse të përcaktuara për Inspektorët Komunal, të njëjtit do të bashkëpunojnë ngushtë edhe me inspektorët e nivelit qendror nga Ministrit e linjës.

Detyrë parësore e inspektorëve do të jetë që në afatin më të shkurt të mundshëm do të ju përgjigjen kërkesave të qytetarëve dhe organeve qendrore dhe komunale.

Për të njëjtat do të mbajnë evidencë zyrtare, do të ju përgjigjen palëve dhe do të raportojnë në organet përkatëse.

Do të hartojnë planet periodike dhe vjetore për mbikëqyrjen inspektuese sipas detyrës zyrtare,

Gjate vitit 2022 Drejtorati për Inspekcion, gjegjësisht inspektorët sipas fushe veprimtarive përkatëse kryesisht do të zhvillojnë aktivitetet si vijon:

| Aktiviteti | Koha | Bartësi |
|------------|------|---------|
| | | |

| | | |
|--|--|--|
| <p>Koordinimi i aktiviteteve ndër-inspektorial (tregut, ndërtimit, mjedisit).</p> <p>Kontrollimi i produkteve për tregtim te artikujve ushqimor dhe jo-ushqimor, theksimi i çmimeve të mallrave të dedikuara për treg.</p> <p>Mbikëqyrje parandalim të ndotjes mjedisore nga substancat kontaminuese /rrezikshme me ndikim të rrezikshëm në tokë, ujë dhe ajër.</p> <p>Shqyrtim i kërkesave të parashtruara nga personat fizike dhe juridike.</p> <p>Kontrollimi i përmbajtjes se orarit të punës sipas Rregullores komunale</p> <p>Zbatim i Rregullores Komunale mbi plotësimin e kushteve minimale teknike dhe sanitare nga aspekti i hapësirave punuese si dhe pajisjeve dhe stabilimenteve për punë.</p> | <p>Çdo fillim jave.</p> <p>Së paku njëherë në muaj dhe sipas ankesave të konsumatorëve</p> <p>Në vazhdimësi dhe sipas kërkesave.</p> <p>Në vazhdimësi sipas kërkesave të arritura.</p> <p>Së paku njëherë në muaj dhe sipas kërkesave dhe ankesave</p> <p>Në vazhdimësi varësisht nga kërkesat</p> | <p>Të gjithë inspektorët</p> <p>Inspektori i Tregut</p> <p>Inspektori i Ambientit</p> <p>Secili inspektor sipas fushveprimtarisë.</p> <p>Inspektori i Tregut</p> <p>Inspektori i tregut dhe i ambientit.</p> |
| <p>Inspektim dhe rregullim i tregut të gjelbër.</p> <p>Inspektimi i objekteve ndërtimore pas njoftimit të organit kompetent për dhënien e lejes ndërtimore lidhur me zbatimin e lejes (në fillim dhe përfundim të punimeve)</p> | <p>Njëherë në javë ditën e tregut</p> <p>Sipas nevojës</p> | <p>Inspektori i tregut</p> <p>Inspektori i Ndërtimit</p> |

| | | |
|---|--|------------------------|
| Inspektimi në teren për ndërtimet pa leje dhe ndërmarrja e masave parandaluese, | E vazhdueshme | Inspektori i Ndërtimit |
| Mbikëqyrje aktiviteteve më ndikim negativë në mjedis si dhe mundësitë e parandalimit të tyre. | E vazhdueshme | Inspektori i Ambientit |
| Ndalimi i eksploatimit të rërës dhe zhavorrit dhe degradimi i lumenjve. | E vazhdueshme | Inspektori i Ambientit |
| Kontrolle/mbikëqyrje pjesës urbane dhe rurale për mbrojtje të mjedisit nga hedhja e mbeturinave amvisërisë dhe mbeturinave inerte. | E vazhdueshme | Inspektori i Ambientit |
| Mbikëqyrja inspektuese e subjekteve ekonomike që me veprimtarin e tyre gjenerojnë mbeturina inerte të pa rrezikshme. | E vazhdueshme | Inspektori i Ambientit |
| Mbikëqyrja inspektuese e operatorëve që posedojnë leje për operim me mbeturina të pa rrezikshme dhe e operatorëve që veprimtarin e kryejnë pa leje përkatëse. Mbikëqyrja e inspektuese e ndotësve të ujit, ajrit etj. | E vazhdueshme | Inspektori i Ambientit |
| Identifikimi i deponive ilegale dhe propozimi i masave për eliminimin e tyre | Prill | Inspektori i Ambientit |
| Koordinimi i aktiviteteve me ministrinë dhe inspektorët përkatës | Sipas kërkesave dhe nevojës | Të gjithë Inspektorët |
| Hartimi i raporteve mujore të punës nga secili inspektor sipas lëmisë përkatëse, | Në fillim të çdo muaji për muajin paraprak | Të gjithë Inspektorët |

Këto janë në parim aktivitetet e Drejtoratit për vitin 2022 që nuk kufizohen vetëm me këto. Secili nga inspektorët do të hartoj plan detaj të aktivitetit të mbikëqyrjes inspektuese.

Ligjet dhe aktet nënligjore në vijim duke mos përjashtuar edhe orientimet strategjike të Ekzekutivit komunal, do të jenë norma mbështetëse e punës së inspektorëve sipas lëmive përkatëse:

- Ligji mbi Tregtinë e Brendshme, nr 2004/18,
- ligji për mbrojtjen e konsumatorit, nr 204/17,
- Ligji për inspektoratin e tregut, 03/L-118,
- Ligji për njësitë matëse, 2004/11,
- Ligji për metrologji, 03/L-203,
- Ligji për kontrollin e duhanit, 04/L-156,
- Ligji për veterinarin, 2004/21,
- Ligji për kujdesin ndaj kafshëve , 02/L-10,
- Ligji mbi ndërtimet, nr. 04/L-110
- Ligji për mbrojtjen e mjedisit me Nr. 03/L-025 2009 10 Gusht 2011
- Ligji për mbrojtjen e natyrës me Nr.03/l-233 2010 28 Maj 2013
- Ligji për mbeturina me Nr. 04/L-060 2012 24 Shtator 2012
- Ligj për vlerësimin strategjik mjedisor me Nr. 03/L-230 2010 10 Gusht 2011
- Ligj për vlerësimin e ndikimit në mjedis me Nr. 03/L-214 2010 10 Gusht 2011
- Ligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes me Nr. 03/L-043 2009 10 Gusht 2011
- Ligjin për mbrojtjen nga zhurma me Nr. 02/L-102 2007 10 Gusht 2011
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja me Nr. 03/L-160 2010 25 Shkurt 2010,
- Udhëzim Administrativ MMPH-nr. 13 /2017 për menaxhimin e -mbeturinave medicinale-patologjike
- Udhëzim Administrativ MMPH-nr. 12 /2017 për shpalljen e llojeve të egra strikt të mbrojtura
- Udhëzim Administrativ MMPH - nr. 02/2017 për listën e kategorive të mbeturinave të rrezikshme sipas origjinës
- Udhëzim Administrativ MMPH - nr.27/2014 për menaxhimin e mbeturinave nga ambalazhet dhe paketimet
- Udhëzim Administrativ MMPH – nr.24/2014 për klasifikimin e vlerave të mbrojtura të natyrës sipas rëndësisë
- Udhëzim Administrativ Nr.06/2008 për administrimin e mbeturinave te rrezikshme
- Udhëzimi Administrativ nr. 2005/12 për përmbushjen e kushteve minimale teknike për lokale afariste,
- Udhëzimi Administrativ nr. 09/2015 Mjedisi pa tym duhani dhe vendosja e shenjave për ndalimin e përdorimit të duhanit në hapësira të mbyllura,
- Udhëzimi Administrativ MMPH 05/2017 për mbikëqyrjen inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit,
- Rregullorja Komunale mbi plotësimin e kushteve minimale higjienikë-teknike për punë,
- Rregullorja Komunale mbi lartësinë e taksave , ngarkesave dhe gjobave për shërbime komunale,
- Rregullorja Komunale mbi orarin e punës për lokalet afariste, objektet hoteliere dhe shërbime tjera në komunën e Deçanit,

-Rregullorja mbi ndalimin e ekspozimit të mallrave ushqimore jashtë hapësirave të lokaleve afariste,

Kërkesë për kryetarin e Komunës z. Bashkim Ramosaj;

Për mbarëvajtjen dhe kryerjen me sukses të punëve dhe detyrave të drejtoratit, kërkoj nga Kryetari i komunës të ndërmerr veprimet në vijim që brenda mundësive të bëhet kthimi i vendit të punës së inspektorit të ndërtimeve që padrejtësisht është bartë në Drejtoratin e Shërbimeve Publike, me qëllim të kryerjes efikase dhe me kompetenca të plota të detyrave të Inspektorit të Ndërtimit.

Drejtori

Halil Tolaj